

Data 24.10.2022

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim
(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Shërbim tre vjeçar i konsulencës kontabël dhe fiskale **(te ardhurat e Eco Tirana sh.a)**
Ref-47141-10-24-2022

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- 66
- 66171000-9

VLERA E FONDIT LIMIT:

6.696.000 (gjashte milion e gjashteqind e gjashtedhete e nente mije)Lekë pa tvsh
(te ardhurat e Eco Tirana sh.a)

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Eco Tirana sha ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- c. Formulari i ofertes ekonomike sipas Shtojcës 1 dhe 2;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pike plotësohet me dorëzimin e *Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet nënenin 26, e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Vërtetim nga organet tatimore, për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021 ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në përcaktimin e vlerës së xhiros vjetore autoriteti kontraktor i është referuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Seksionit III, Neni 43 pika 2, gërma (c).

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2. Kopje të çertifikuara të bilanceve vjetore të paraqitura pranë autoriteteve tatimore përkatëse për vitet financiare 2020, 2021, ku bilanci i dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” nenit 55 pika 4b ku është përcaktuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.4. Kërkesa te tjera

2.4.1. Liçensat profesionale lidhur me shërbimet objekt i kontratës:

1. Operatori ekonomik duhet te jete i pajisur me licence profesionale kontabel i miratuar te regjistruar prane organizates te profesionistev te lire (personi duhet te figuroje dhe ne listpagesat e shoqerise).
2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore të shoqëruar me listpagesat, për përmbushjen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore, për fuqi punëtore të paktën 10 (dhjete) punonjës rregullisht të punësuar, listë pagesat te jene te konfirmuara prane autoritetit perkates përperiuadhën Janar 2021 – Shtator 2022, për realizimin e objektit të prokurimit.
3. Operatori ekonomik duhet te jete i pajisur me program finaciar Financa5,Quickbooks premier deskopUK. Per kete duhet te paraqese dokument fature blerje ose nje deklarate ose cdo dokument tjetër vertetues.
4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një policë sigurimi në favor të Autoritetit Kontraktues për të mbuluar dëmet e shkaktuara nga neglizhenca, gabimet dhe / ose lëshimet e ofruesit dhe / ose punonjësve te tij në lidhje me aktivitetet që duhet të ofrohen.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 germa a dhe b dhe pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Hartimi i specifikimeve teknike është kryer duke iu referuar kërkesave dhe nevojave të autoritetit kontraktor Eco Tirana sh.a. në fushën e veprimtarisë së tij.

Artikulli/ Sherbimi	Pershkrimi / Specifikimet teknike	Njesi matese	Sasia
Sherbim konsulence administrative dhe fiskale	Titulli i procedurës: Shërbim tre vjecar i konsulencës kontabël dhe fiskale. Shërbimi i realizimit të listës së pagave. Detaje të shërbimeve të kërkuara të konsulencës kontabël dhe fiskale, asistence me personelin dhe trajnime specifike: Konsulencë kontabël periodike, konsulencë dhe asistencë në mbajtjen e regjistrit të asetëve dhe regjistrit të inventarit, raporte dhe analiza kontabël, nëpërmjet hartimit të raporteve provizore përgjatë vitit (si për shembull bilanc vërtetues, pasqyra e	Vite	3

	<p>performancës, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e fluksit të parasë, raporte të konsoliduara, raporte menaxhimi të kërkuara nga aksionarët etj.), përgatitja e pasqyrave financiare, mbajtja e të gjitha deklarimeve tatimore të Shoqërisë (përvec deklarimeve dhe c’deklarimeve të punonjësve). Asistencë ndaj audituesit për auditimin vjetor të pasqyrave financiare.</p> <p>Konsulencë mbi kuadrin ligjor në fuqi (si edhe ndryshimet e ndodhura përgjatë kohës së vlefshmërisë së kontratës) në fushën kontabël dhe fiskale. Trajnim i personelit të Shoqërisë. Asistencë në përgatitjen e planeve ekonomike shumëvjeçare. Asistencë gjatë inspektimeve të Organeve të Kontrollit për çështjet kontabël dhe fiskale. Asistencë për marrëdhëniet me sistemin bankar dhe për menaxhimin dhe/ose marrjen e linjave të kredive, huave apo formave të tjera të financimit.</p> <p>Asistencë për përgatitjen e të gjitha raportimeve të kërkuara nga ligji dhe nga Aksionarët e Shoqërisë.</p> <p>Detaje të shërbimeve të kërkuara për përgatitjen e listës së pagave:</p> <p>Përlllogaritje e pagave dhe printim në PDF i formularëve të pagave mujore të punonjësve (maksimumi deri në 300 në muaj) me përpunimin e raporteve mujore të orëve të punës, pagave bruto, orëve jashtë orarit, shtesave dhe zbritjeve të ndryshme, organizimin sipas mënyrave të pagesës. Përgatitja e deklaramit mujor të pagave. Asistencë për transmetimin e raportimeve periodike për zyrën e punës dhe inspektoratin e punës. Asistencë gjatë inspektimeve të Organeve të Kontrollit në fushën e përlllogaritjes se pagave. Asistencë për procedurat e raporteve mjekësore, barrë lindjes dhe të tjera të lidhura me personelin sipas dispozitave ligjore të fushës.</p> <p>Autoriteti Kontraktor disponon programin kompjuterik Financa 5, operatori ekonomik duhet të sigurojë aksesin në programin kompjuterik online për të gjitha të dhënat e kontabilitetit dhe inventarit.</p> <p>Kohëzgjatja e emërimit: Nga 01 Janar 2023 deri në miratimin e pasqyrave financiare të Shoqërisë për vitin 2025(maj 2026).</p> <p>Karakteristikat minimale të ofruesit të shërbimit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shoqëria të këtë staf të kualifikuar dhe zyrë në Tiranë. <p>1. Disponueshmëria e programit software që vijon:</p>		
--	--	--	--

	<p>Financa 5 dhe quickbooks premier deskop UK</p> <ul style="list-style-type: none"> Ofruesi duhet të paraqesë një policë sigurimi në favor të Autoritetit Kontraktues për të mbuluar dëmet e shkaktuara nga neglizhenca, gabimet dhe / ose lëshimet e ofruesit dhe / ose punonjësve të tij në lidhje me aktivitetet që duhet të ofrohen. Në stafin e zyrës duhet të jetë i punësuar të paktën një kontabël i miratuar (duhet të figurojnë edhe në listepagesat e shoqërisë për një periudhë 7 vjeçare) <p>Kushtet e pagesës.</p> <p>Fatura mujore (shërbim gjithëpërfshirës) paguar në Bankën Intesa SanPaolo 60 ditë pas pranimit të faturës </p>		
--	---	--	--